



Komuna Klinë

Debat me Publikun

01Nr 06-15847 /19

Klinë: 19.04.2019

PROCESVERBAL

Nga mbledhja Debat me Publikun e mbajtur më 15.04.2019 në sallën e Kuvendit të Komunës,
me fillim në orën 10:00.

Rëndi i Dites

1. Shqyrtimi i Draft-Rregullores për themelimin dhe strukturimin e asamblesë Komunale të Fëmijëve.

Në mbledhje ishin prezent:

Fadil Gahi- Kryesues

Hajdin Morina nga DKA

OJQ"KOHA"- Florida Gashi

Si dhe 20 pjesëmarrës tjerë, qytetarë të komunës sonë.

Debatin me Publikun e hapi z. Fadil Gashi kryesues, fillimisht pashëndeti të gjithë të pranishmit, tha, jemi duke shfrytëzuar infratraktukturen ligjore ligjin për vetëqeverisjen lokale, rregulloren e punës së kuvendit, ne kemi filluar shqyrtimin e rregullores për themelimin dhe strukturimin e asamblesë Komunale të fëmijëve, ju njoftoj se asambleja e fëmijëve ka ekzistuar edhe me parë, por nuk ka pas ndonjë rregullore që e rregullon ma detaisht, përgjegjësit, strukturën dhe aktivitetet e kësaj asambleje për fëmije, ne e kemi shqyrtuar edhe në komitetin për politik dhe financa, ne e kemi marr vendim në mbledhje e fundit të asamblesë komunale për ta lëshuar në diskutim publik, dhe ky takim i sotit mund të sjell rezultat, ne do të vazhdojmë të pranojmë komente, sugjerime, plotësime kërkesa, deri në mbledhjen e radhës ku edhe do të votohet në kuvend, ku do të aprovohet dhe pastaj merr formën e prerë, deri atëherë, te gjitha ato kategori që preken nga kjo draft-rregullore kanë mundësi të shtrojnë kërkesat, apo sugjerimet e tyre, jemi të

hapur për krejt ato që ju mendoni që mund të ndryshojmë, unë pa humbur shumë kohë po i jap fjalën drejtorisë së arsimit urdhëroni profesor Hajdin Morina.

z.Hajdin Morina, Faleminderit kryesues i kuvendit, Përshëndetje të gjithëve, zyrtarë, përfaqësues të syri vizionit, mësues, drejtor shkollave, siç e paraqiti edhe kryesuesi është draft-rregullorja për themelimin dhe strukturimin e asamblesë komunale të fëmijëve, për debat rreth kësaj draft-rregulloreje kemi bërë krejtësisht drejtorin e arsimit, në këtë draft-rregullore kanë punuar edhe organizata që e kanë ndihmuar vazhdimisht drejtorin e arsimit në Klinë, organizata siç the children, syri vizion, drejtor etj, kjo asamble veq ka funksionuar me parë por duhet të zgjidhet asambleja e re tani, kanë nevojë edhe shkollat që ta kenë, kjo i ndihmon edhe komunës si një organ me shumë që të lexhitim dhe ti avancoj të drejtat e fëmijëve, sidomos të drejtat e nxënësve në shkollë, që tu ndihmoj edhe komuna që të drejtat e nxënësve që u takojnë me ligjë dhe me rregullore të tjera të shkollës të mos u shkelen, draftin e kësaj rregullore nuk do ta elaboroj shumë për arsye që u tha edhe kryesuesi, kjo do të debatohet edhe nga ju, ne si drejtori e arsimit e kemi përpunuar këtë rregullore, dhe kërkojmë që të merren edhe mendimet e juaja e pastaj të ju dërgohet anëtarëve të kuvendit për votim, vlen të ceket se kjo asamble do ta ketë numrin e anëtarëve po që sa ka asambleja e kuvendit të komunës, do të kenë bashkëpunim mes vete patjetër dhe asambleja komunale do ta ndihmoj asamblenë e fëmijëve me mundësi bugjetore, morale, ligjore dhe me të gjitha të tjerat,

Ne drejtorin e arsimit propozojmë që neni 22 Mjetet dhe financimi

22.1 ku ceket se mjetet e nevojshme për funksionimin dhe financimin e aktiviteteve realizohen përmes: planifikimit buxhetorë komunal dhe qeveritarë (buxhetimit miqësorë për fëmijë), mbledhjes së fondeve, shkollat, kontributet vullnetare të nxënësve , mësuesve, prindërve dhe donacionet nga organizatat e biznesit, si dhe donatorë të tjerë,

Ne kemi dashur që neni 22.1 i nenit 22 ta ndërrojmë por nuk do të ndikoj që të zhvillohen aktivitetet tjera, p.sh. me donator me an tjera të mbledhjes së buxhetit,

Ne kemi menduar që kjo të zëvendësohet kështu:

22.1 Drejtorin Komunal e Arsimit mbështet mbrenda mundësive buxhetore aktivitetet e ndryshme, festive dhe kulturore të asamblesë të fëmijëve në Klinë

Faleminderit për dëgjim,

Z.Fadil Gashi, faleminderit për prezantim profesor i nderuar, unë po kam debat të gjithë ju që jeni prezent nëse dikush ka ndonjë vërejtje apo sugjerim urdhëroni, ne i falënderojmë të gjithë ata të cilët kanë punuar që kjo draft-rregullore të vijë para nesh, ne mund të plotësojmë ende përderisa nuk është miratuar për kuvend, po shohë shumë organizata të cilat do të preken nga kjo draft-rregullore nëse ka dikush për të shtuar urdhëroni,

Znj. Teuta Uka, nga organizata Syri Vizion, tha e falënderoj komunën e Klinës për përkrahje dhe bashkëpunim, duke parë që asambleja e fëmijëve ka jep kontribut shumë të madh në qeverisjen dhe në të drejtat e fëmijëve nëpër shkolla, në përveç Klinës në punojmë edhe me komunitet tjerë, në komunitet tjerë është në proces e sipër kjo rregullore, me hartimin e kësaj rregullore që është iniciuar nga organizata jonë dhe ajo seiv the children ku edhe ju keni qenë pjesëmarrës, tek qeshtja e mbështetjes është diskutuar shumë gjatë tek financimi, sipas përvojës ku ata kanë organizuar ndonjë aktivitet si p.sh për ditën e Tokës ose ndonjë iniciativë ta ndihmojnë dikënd kanë organizuar në mënyra të ndryshme jo vetëm me financim nga komuna, ne jemi duke punuar me nivelin qendrorë që ta kenë një kod buxhetorë që i dedikohet kryesisht fëmijëve, pastaj ti marrin ato mjete për aktivitete të ndryshme, ju faleminderit kaq pata.

Z.Fadil Gashi, faleminderit z.Teuta, ne kemi një praktikë në miratim të akteve që bëhen nga kuvendi i Komunës, në fund i bashkëngjitet edhe një dokument, vlerësim financiar nga drejtoria e financave, e vlerësojmë koston e secilit akt juridikë, por po besoj që edhe propozimi i DKA-së është edhe i bazuar edhe i arsyeshëm, sepse është një formë se si ndërtohet buxheti dhe tjetra se si shpenzohet, ne jemi të obliguar ta respektojmë atë, pa e lënduar as pjesën tjetër të cilën e ceket ju, nëse ka dikush diçka tjetër urdhëroni.

Z.Dodë Grabanica, faleminderit kryesues, falënderoj të gjithë të pranishmit, është për tu përshëndetur ky takim edhe pse ka qenë mirë që takimet të jenë me të shpeshta, arsyeja se edhe nxënësit e ndien veten me mirë dhe kanë edhe shpresë për një të ardhme, me pëlqej atë ndryshim nga drejtoria e arsimit, unë mendoj se edhe financimet nga organizatat që i financojnë apo që bëjnë ndonjë financim apo diçka është mirë që çdo gjë të shkojë në vijë institucionale dhe ta dijmë kush qka pruni, kush qka dha, dhe ta dijmë se si janë shpenzuar ato mjete, ne si drejtor shkollave jemi të kufizuar me buxhet, kemi nevojë për gjelbërim në shkollë, prandaj kjo do të shkojë në bazë të kërkesave kaq kisha ju faleminderit.

Z.Fadil Gashi, faleminderit drejtor, për takime me të shpeshta unë ju bëj ftesë miqësisht të gjithëve seancat janë të hapura për të gjithë, çdo gjë është publike, të gjithë mund të marrin pjesë, por jo vetëm në seancat e kuvendit por edhe në komitete, nëse ju e shihni që është në interes të juaj mos hezitoni marrin pjesë dhe paraqitni propozimet e juaja, dhe unë besoj se do të vijë deri në kuvend, nëse nuk ka dikush diçka për të shtuar unë ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrje, uroj që kjo draft-rregullore të ju shërbejë atyre që është në interes të tyre që ne jemi duke punuar që ta aprovojmë këtë draft-rregullore.

Mbledhja debat me publikun përfundoj në ora 10:30

Procesmbajtësi,
Ahmet Berisha



Kryesuesi,
Fadil Gashi

